

*BellTours*

**VALENCIA**

**5 - 8 TETOR 2024**

## DITA 1 - E SHTUNË, 5 TETOR 2024

Ora 20.10 Nisja nga Tirana. Ora 23.05 Mbërritja në Valencia. Transferta në Sh Colón Valencia Hotel 4\* (B&B).

## DITA 2 - E DIEL, 6 TETOR 2024

Mëngjesi në hotel. Ditën do ta nisim duke eksploruar Valencian në një mënyrë të këndshme. Me biletë 48-orëshe do të zhvillojmë një tur të gjithë qytetit me autobusin Hop-on Hop-off, ku nëpërmjet udhëzuesit audio dhe 17 ndalesave do të mësojmë për monumentet kryesore të qytetit. Më tej, do të ndalemi të vizitojmë muzeun Falla. Muzeu Falla në Valencia është një institucion kulturor që u kushtohet festimeve të famshme të Fallas, një traditë e vjetër valenciane që zhvillohet çdo vit, në muajin mars. Muzeu përmban një koleksion të gjerë figurash dhe elementësh dekorativë të njohur si "ninots," të cilët janë krijuar nga artistë të ndryshëm dhe paraqesin skena humoristike, satirike dhe historike. Muzeu Falla është një 'must' në Valencia. Drekë te Qyteti i Arteve dhe Shkencave.



Pas drekës do të zhvillojmë një vizitë në këmbë të Qytetit të Arteve dhe Shkencave: Oceanografico, Hemisfëric, Príncipe Felipe Science Museum, El Palacio de las Artes Reina Sofia, Umbracle dhe Ágora. I vendosur në shtratin e



vjetër të lumit Turia, Qyteti i Arteve dhe Shkencave është një kompleks argëtimi i projektuar nga arkitekti prestigjioz Santiago Calatrava. Ky grup ndërtesash shquhet për dizajnin avangard, i cili është kthyer në një simbol të Valencias. Vendi bashkon gjithsej gjashtë hapësira të

ndryshme: Hemisfëric, Oceanografic, Muzeun e Shkencave Príncipe Felipe, Umbracle, Pallatin e Arteve Reina Sofia dhe Ágora. Darkë në Ruzafa, lagjia më 'cool' e Valencias, një lagje moderne e mbushur me kafene, bare, klube e restorante.

Mëngjesi në hotel. Me autobus nisemi për në Parkun Natyror të Albuferës. Ky park është një nga zonat më të rëndësishme ekologjike në Spanjë. Ai përfshin një liqen të madh të ujërave të ëmbla dhe një lagunë të ndërlidhur me detin përmes kanaleve. Albufera është një habitat i rëndësishëm për shumë lloje shpendësh, duke e bërë atë një vend të preferuar për shikimin e zogjve. Përveç pasurisë së tij biologjike, parku ofron aktivitete si: ecja, çiklizmi dhe varkat tradicionale që lejojnë vizitorët të eksplorojnë bukuritë natyrore të zonës. Zona është e rrethuar nga fusha të



gjera orizi dhe toka bujqësore që furnizojnë qytetin. Në këtë park do të zhvillojmë

një shëtitje me varkë dhe vizitë në fshatin El Palmar, një fshat i vogël me 800 banorë, i cili në aspektin kulturor dhe mjedisor është zemra dhe shpirti i La Albuferas. Më pas mund të provojmë dhe gastronominë lokale, Paella-n e famshme, tradicionale të Valencias, e cila origjinën e ka në La Albufera. Kthimi në Valencia. Kohë për të



pushuar dhe më pas, me autobusin Hop-on Hop-off do të shkojmë në stacionin



“Hotel Balneari Les Arenes”, në plazhin El Cabanyal, ku mund të shijoni dhe larjen në det (PO edhe në tetor!). El Cabanyal është një lagje historike dhe bregdetare në Valencia, e njohur për arkitekturën e saj unike dhe atmosferën e gjallë. Dikur një fshat peshkatarësh, El Cabanyal ruan ende karakterin e tij të veçantë me shtëpi të ngushta dhe fasada shumëngjyrëshe, të zbukuruar me pllaka qeramike tradicionale. Lagja ka një histori të pasur dhe një komunitet të fortë lokal që ka luftuar për të ruajtur trashëgiminë e saj kulturore dhe arkitekturore përballë planeve të modernizimit dhe zhvillimit.

El Cabanyal është gjithashtu një vend i njohur për evente kulturore dhe artistike, me shumë galeri, teatro dhe festivale lokale që tërheqin vizitorë nga e gjithë bota. Një shëtitje nëpër rrugët e tij ofron një përvojë autentike të jetës valenciane, me mundësi për të shijuar kuzhinën lokale në restorante dhe bare të vogla, si dhe për të përjetuar mikpritjen dhe traditat e komunitetit vendas. Darkë në El Cabanyal.

#### **DITA 4 - E MARTË, 8 TETOR**

Mëngjesi në hotel. Tur i qytetit, Ciutat Vella, me guidë lokale italisht. Ciutat Vella, zemra historike e Valencias, është distrikti i shesheve madhështore dhe ndërtesave historike, si dhe i artit të rrugës dhe bareve tapas. Valencia ka një nga qendrat më të mëdha historike të Evropës. Më shumë se 2000 vjet histori kanë lënë një ndikim të thellë dhe një trashëgimi të pasur artistike. Vende si: La Lonja (Këmbimi i Mëndafshit) dhe Tribunali de las Aguas (Tribunali i Ujërave), janë pjesë e trashëgimisë UNESCO. Duke u endur nëpër labirintin e rrugëve të ngushta, do të arrijmë në disa sheshe të mëdha. Këtu do të gjejmë pallate dhe kisha të bukura nga periudha të ndritura të historisë së qytetit, si dhe muze të shumtë.



Drekë në Mercad Central, një nga veprat kryesore të Art Nouveau Valenciane. Tregu më i madh i produkteve të freskëta në Evropë, përveçse shquhet për ofertën e tij të pasur dhe të larmishme ushqimore, ndodhet në një nga ndërtesat më emblematike moderniste në qytet. Me një sipërfaqe prej më shumë se 8000 metra katrorë, struktura e saj, e përbërë nga kolona hekuri, të kujton Kullën Eifel. Pas drekës, disa opsione sipas dëshirave tuaja: Kohë e lirë për shëtitje dhe shopping; Vizitë e monumenteve kryesore të Valencias ose një tur me biçikletë. Përpara largimit nga Valencia, sugjerojmë një darkë në Barrio Del Carmen ose Mercat De Colon.

**Barrio Del Carmen**, kombinimi perfekt i historisë dhe kohës së lirë. Lagjja El Carmen është më i njohura nga lagjet e Valencias. Njihet si një ëndërr për adhuruesit e kuzhinës mesdhetare dhe kohës së lirë. Edhe pse gama e restoranteve dhe ambienteve është e madhe, kjo lagje është, gjithashtu, një zonë e Ciutat Vella me një histori mijëravjeçare dhe shembuj të mrekullueshëm të arkitekturës mesjetare, trashëgimi të pasur artistike, qindra anekdota historike dhe origjina e një numri të konsiderueshëm legjendash lokale.

**Mercat De Colon**, ushqim shumë i mirë në një mjedis unik. Në kohët e kaluara ishte një treg, sot është shtëpia e tezgave me lule dhe restoranteve më të mira. Ka qenë gjithmonë një nga ndërtesat më të bukura në Valencia. Colón Market u projektua nga arkitekti Francisco Mora Berenguer në fillim të shekullit të 20-të, duke e bërë atë një nga shembujt më ikonë të Art Nouveau valenciane, i cili ka disa veçori që të kujtojnë ndërtesat e Gaudit, në Barcelonë.

Ora 21.15 Nisja drejt aeroportit. Ora 23.45 Nisja për në Tiranë. Ora 02.30 Mbërritja në Tiranë.

## OPSIONALE:

### 1. Vizita në Qytetin e Arteve dhe Shkencave

- Hemisfèric 7 eur
- Oceanografico 37 eur
- Muzeu i Shkencës Príncipe Felipe 7 eur

### 2. Vizitë e monumenteve kryesore të Valencias

- Marquis of Dos Aguas Palace – Muzeu i qeramikave 3 eur
- Almoina - Muzeu arkeologjik 2 eur
- The Valencia Cathedral 9 eur
- La iglesia de San Nicolás de Bari  
Kisha e Shën Nikollës së Barit 11 eur
- Quart Towers 2 eur
- The Silk Exchange 2 eur

### 3. Bike Tour 35 eur

### 4. Kohë e lirë për shopping

### **PËRFSHIHEN NË ÇMIM:**

- Biletat e avionit Tiranë – Valencia – Tiranë, me çantë shpine;
- Transferta aeroport – hotel – aeroport;
- Prenotimi i hotelit SH Colón Valencia Hotel, 4\* për 3 netë, me mëngjes të përfshirë;
- Siguracioni i shëndetit në udhëtim;
- Autobusi Hop-on Hop-off për 48 orë;
- Vizitë në Muzeun Faller de València;
- Autobusi për në Parkun Albufera;
- Shëtitje me varkë në parkun Albufera;
- Tur i qytetit 3 - 4 orë me guidë lokale në gjuhën italiane.

### **NUK PËRFSHIHEN NË ÇMIM:**

- Valixhe dore 10 kg;
- Drekat dhe darkat;
- Vizita opsionale;
- Çdo shpenzim tjetër që nuk përmendet më sipër.

### **FLUTURIMET:**

- Tiranë / Valencia            20:10 – 23:05
- Valencia / Tiranë            23:45 – 02:30